

**ALBANA MEMA****DISA ASPEKTE TË OPOZITARIZMIT NË SHQIPËRI NË VITET  
1920-1924**

Rifillimi i jetës shtetërore pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat kishte kaluar shteti shqiptar para kësaj lufte dhe gjatë Konferencës së Paqes, ishte shumë inkurajuese për Shqipërinë, nëse kjo gjykohet nga pikëpamja e ndërtimit të një shoqërie demokratike, e cila, është ideali i çdo kombi të civilizuar. Por, për kushtet e Shqipërisë, parë kjo në këndvështrimin praktik dhe pragmatist, atë të stabilizimit të shtetit dhe të institucioneve të tij, që ishte detyra themelore dhe më e rëndësishme e kohës, ky model institucional politik, ishte jo vetëm një sfidë e madhe, gati e pakapërcyeshme por, edhe një sprovë e rrezikshme, e cila mund të hidhte në erë ato suksese të arritura në ripërtëritjen e shtetit kombëtar, pas krizës së rëndë që ai kaloi në Konferencën e Paqes dhe përballë rreziqeve të copëtimit dhe të shpërbërjes, që ende nuk ishin tejkaluar. Në këtë artikull, do të analizojmë opozitën shqiptare, si një element dhe institucion themelor i këtij sistemi qeverisës.

Në çdo shoqëri demokratike, veprimtaria e opozitës ka rëndësi vendimtare për shkallën e suksesit të ndërtimit, afirmimit dhe konsolidimit të institucioneve kombëtare. Në këtë artikull do të përpiqemi të bëjmë disa analiza dhe komente mbi cilësitë dhe karakteristikat e saj, krahasuar me rolin standard të një opozite normale. Krahasuar me opozitat e vendeve të fuqishme demokratike, opozita shqiptare kishte disa mangësi esenciale dhe strukturore. Ajo nuk kishte një lider gjithëpërfshirës, përbëhej nga grupe me objektiva politike diametralisht të kundërta dhe të paqëndrueshme, kishte një profil lokalist etj. Fryma politike programatike dhe liberale e opozitës mbahej e gjallë nga një grupim intelektualësh të njohur të vendit por shumica e elektoratit të saj ishte shumë e paqartë rreth qëndrimeve të tyre.

### **Fillimet e opozicionit në Shqipëri në vitet 1920-1921**

Që në fillim, qeveria e Sulejman Delvinës u ndesh me kundërshtimin e ish pjesëtarëve të qeverisë së Durrësit dhe të forcave që i mbështesnin ato. Menjëherë pas marrjes së pushtetit, qeveria filloi punën për vendosjen e kontrollit mbi territorin, por kjo do të ishte një detyrë tepër e vështirë, pasi në vend gjendeshin ushtritë italiane dhe ekzistonte një anarki e madhe e cila, në më të shumtën e rasteve, ishte e nxitur dhe e krijuar prej tyre. Grupi i politikanëve që mbetën të pakënaqur nga rrëzimi i qeverisë së Durrësit dhe që nuk u përfshinë në qeverinë e re përbënte opozitën e parë të rëndësishme në sistemin e ri politik të krijuar nga Kongresi i Lushnjës. Kjo opozitë ishte kryesisht joparlamentare pasi shumica e këtyre politikanëve nuk ishin përfshirë në Senatin që krijoi Kongresi i Lushnjës. Si e tillë kjo opozitë përbënte një rrezik potencial destabiliteti e konflikti për vendin. Përveç kësaj forme të opozicionit qeverisë së S. Delvinës i ra barra e rëndë të përballej me lëvizje dhe forca antishtetërore dhe separatiste të brendshme, të cilat nxiteshin dhe ushqeheshin nga faktorë të jashtëm të drejtuar kundër unitetit të shtetit kombëtar, karakterit të tij të pavarur, kombëtar dhe të centralizuar, si dhe kundër tërësisë tokësore të tij.

Shumë shpejt qysh në verën e vitit 1920 edhe brenda Senatit që krijoi Kongresi i Lushnjës filluan të shfaqen pakënaqësitë dhe mosmarrëveshjet e para serioze politike. Në këtë Senat forcën kryesore politike që ishte më e organizuara dhe më e forta politikisht e përbënte Krahu Kombëtar e cila ishte një organizatë gjysëmilegale por që njihej gjerësisht në vend. Ajo ishte krijuar para Kongresit të Lushnjës dhe kishte luajtur një rol të madh në organizimin e tij. Përçarjet, mosmarrëveshjet dhe konfliktet e brendshme në këtë organizatë politike do të shërbenin si evenimente nxitëse të krijimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të opozitës legale parlamentare në Shqipëri me të cilën do të bashkëpunonin më vonë edhe elementë e grupe të tjera të pakënaqura nga qeverisja.

#### *Irredentizmi - shtysa e parë e krijimit të opozitës*

Sikur mos të mjaftonin vështirësitë e mëdha të ndërtimit të brendshëm, shteti shqiptar përballej me një problem madhor, atë të popullsisive shqiptare të mbetura nën sundimin sllavo-grek. Shteti shqiptar ishte përballë një presioni të dyfishtë. Së pari, ai gjendej përballë presionit të Jugosllavisë dhe të Greqisë, të cilat, duke ndjekur politikën e tyre nacionaliste e shkombëtarizuese, shtypnin në mënyrë brutale

popullsinë shqiptare dhe ushtronin presion që shteti shqiptar të mos dilte në mbrojtje të tyre. Së dyti, shteti shqiptar ishte nën presionin e fortë të një lëvizje irredentiste që drejtohej nga “Komiteti i Kosovës”, i cili, kërkonte marrjen e masave energjike kundër dhunës serbe e greke dhe mbrojtjen me çdo mënyrë të vëllezërve të tyre. Shqipëria përballlej në politikën ndërkombëtare, me një diplomaci agresive të dyshes ballkanike. Por, megjithatë, pala shqiptare tregoi një maturi të admirueshme ndaj tyre. Për të shmangur mosmarrëveshjet me Jugosllavinë qeveria shqiptare ndoqi një politikë shumë të kujdesshme dhe të moderuar ndaj saj. Pikërisht ky qëndrim shkaktoi pakënaqësi dhe kundërshti të drejtuesit kryesorë të KMK.

Përçarja e parë ndodhi në verën e vitit 1920 kur nga Krahu Kombëtar u shkëput një pjesë e rëndësishme e politikanëve të “Komitetit të Kosovës”, Hasan Prishtina, Hoxha Kadriu, Bajram Curri etj. Ky grup do të formonte segmentin irredentist të opozitës shqiptare, i cili do të luante një rol të rëndësishëm në jetën politike të vendit në vitet 1920-1924. Shkaku kryesor i kësaj ndarje u bënë mosmarrëveshjet e thella midis shumicës qeverisëse të asaj kohe dhe “Komitetit të Kosovës” për qëndrimet që duheshun mbajtur ndaj Kosovës. Këto mosmarrëveshje kulmuan në bllokimin e armëve të sjella me iniciativën personale të Hasan Prishtinës në Shqipëri në bashkëpunim me nacionalistin italian D’Annuzio. Sipas Sejfi Vllamasit, të gjithë kosovarët që ishin anëtarë të “Krahut Kombëtar”, përveç Bedri Pejanit, ishin kundër pranimit të armëve të D’Annuzios, kurse të tjerët përveç Beqir Vokshit, ishin për pranimin e tyre pasi këta ishin të bindur se me këto armë do të shpëtonin Kosovën. Aksioni për futjen e armëve në territorin shqiptar për të provokuar një konflikt në Kosovë ishte një veprim tepër i rrezikshëm me pasoja rrënuese për shtetin shqiptar të pastabilizuar dhe të panjohur ndërkombëtarisht. Politika e matur e qeverisë ishte me rëndësi jetike në këto momente tepër delikate.

Qeveria Delvina nuk lejoi shkarkimin e armëve në portin e Shëngjinit, më 1920, për llogari të kryengritësve kosovarë. Vetëkuptohet që një aksion i tillë, do të nënkuptonte luftë midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë dhe kështu do të vihej në lojë ekzistenca e Shqipërisë.

Qëndrimi qeveritar, hapi një debat të madh politik në Tiranën zyrtare dhe çoi në tensionimin e marrëdhënieve me drejtuesit e “Komitetit të Kosovës”. Këtu është edhe zanafilla e një urrejtjeje të egër dhe lufta e pakompromis, e një pjese të udhëheqësve të “Komitetit të Kosovës”,

kundër A. Zogut dhe përgjithësisht, kundër bashkëpunëtorëve të tij, të cilët, më vonë do të formonin “Partinë Popullore” dhe pas zgjedhjeve të vitit 1921, do të drejtonin qeverinë. Pjesa më aktive e “Komitetit të Kosovës” do të shndërrohej në mënyrë të paarsyeshme dhe të dëmshme, në një segment të ashpër dhe tepër të rrezikshëm opozitar, i cili, do të sfidonte dhe do të cenonte stabilitetin e shtetit.

Në periudhën 1920-1924, “Komiteti i Kosovës”, ofroi sfidën kryesore të armatosur kundër Zogut por, edhe kundër qeverive konstitucionale. Sejfi Vllamasi thekson se, “në krye të kësaj aventure të rrezikshme ishte aventurieri guximtar Hasan Prishtina dhe qëllimi i saj, nuk ishte shpëtimi i Kosovës, por synimi për ta vënë qeverinë dhe fatin e Luftës së Vlorës në rrezik”.<sup>1</sup> Ky është një qëndrim shumë kritik, ndaj asaj organizate, që deri më sot është parë vetëm në aspektin pozitiv nga historiografia shqiptare. Por, sado që të mendojmë se në këtë qëndrim të Vllamasit, ka një dozë teprimi dhe jo objektiviteti, shumë fakte flasin se, kjo pjesë e opozitës, në atë kohë, krijoi probleme dhe rreziqe serioze për procesin e stabilizimit të shtetit. Politika e matur e qeverisë shqiptare, ishte me rëndësi jetike, për shkak të pozitës së dobët ndërkombëtare të Shqipërisë si dhe shtrirjes së kufirit tokësor relativisht të gjatë me Greqinë e Jugosllavinë. Si pasojë e këtyre rrethanave, problemet ballkanike, në këto vite, përbënin një truall të përshtatshëm, ku propaganda jugosllave dhe ajo greke luanin lehtësisht.<sup>2</sup> Jugosllavët ishin shumë të vëmendshëm ndaj zhvillimeve në Kosovë.

Kështu, në politikën shqiptare, për shkak të një presioni të madh ndërkombëtar, jo vetëm Zogu, por më vonë edhe Noli, më 1924, nuk u dhanë mbështetjen e pritur kosovarëve. Jugosllavia nga ana tjetër, shpesh e akuzonte politikën e Tiranës, se kishte lejuar që anëtarë të KMK-së të përfaqësoheshin deri në Parlament. Kështu “Komiteti i Kosovës” dhe veprimtaria e anëtarëve të tij, gjatë periudhës që qëndruan në Shqipëri, shërbeu si një pikë mosmarrëveshjeje ndërmjet dy shteteve. Me presionin e saj, Jugosllavia përpiqej të reduktonte mbështetjen që KMK-ja kishte gjetur në qarqe të caktuara politike në Shqipëri.

Mund të themi se opozita shqiptare, nuk pati ndonjë sfond të gjerë të lidhjeve politike ndërkombëtare, me grupe apo parti të huaja. I vetmi

<sup>1</sup> Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, përgatitur për botim nga Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000, f. 230.

<sup>2</sup> Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2005*, Tiranë: Kristalina-KH, 2007, f. 129.

segment i saj, që kishte lidhje të tilla, relativisht të rëndësishme, ishte “Komiteti i Kosovës”. Në gjysmën e dytë të vitit 1922, e sidomos në vitin 1923, vihet re një frymë bashkëpunimi ndërmjet VMRO-së të Maqedonisë e KMK-së, si dhe disa organizatave të tjera ballkanase, të ndikuara nga Bashkimi Sovjetik. Ky drejtim politik i KMK-së, i acaroi edhe më tej marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe madje ngjalli shqetësime edhe në Londër e Paris. Në këtë mënyrë, qeveria shqiptare, në përpjekje për të ruajtur stabilitetin e vendit, u tregua shumë e rezervuar dhe e kujdesshme kundrejt presioneve dhe kërkesave të KMK-së. Drejtësia e qëndrimeve të matura të qeverive shqiptare të viteve 1920-1924, ndaj Jugosllavisë dhe çështjes së Kosovës, të cilat, kishin shkaktuar konfliktin e ashpër dhe të zgjatur me “Komitetin e Kosovës”, u vërtetua gjatë qeverisjes së Nolit, i cili kishte ardhur në pushtet edhe me mbështetjen e KMK-së dhe ishte në aleancë me të.

#### *Përforcime të reja të opozitës*

Në vjeshtën e vitit 1920, pa u forcuar mirë shteti i ri shqiptar filluan rivalitetet e zakonshme, komplotet dhe luftërat për pushtet nga një pjesë e politikanëve që nuk duronin sukseset dhe pozitat që kishin fituar në qeverisje rivalët e tyre. Kishte edhe të tjerë që mezi prisnin të merrnin në dorë frenat e shtetit, për të përjetësuar sundimin e tyre arbitrar dhe për të mbrojtur pasuritë e tyre të mëdha nga reformat e mundshme. Të gjithë këta donin të ndryshonin qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës para se ajo të njihej nga qeveritë e huaja. Një fatkeqësi tjetër ishte se ky fraksionim apo kjo luftë politike shoqërohej me propagandën e hapur dhe të nëndheshme që amplifikonte dasitë krahinore toskë-gegë, myslimanë-të krishterë etj., e cila nxitej edhe nga të huajt për interesat e tyre. Egoizmi tejkaloi arsyen e fortë e cila këshillonte ruajtjen e kohezionit politik dhe të qeverisë së S. Delvinës dhe shmangien e krizave politike. Një oponent i politikës së qeverisë u bë edhe Këshilli i Naltë i cili ishte i pakënaqur që qeveria nuk këshillohej me të për shumë probleme. Presionet për dorëheqjen e qeverisë duket sa kanë qenë edhe nga brenda saj si dhe nga radhët e Senatit. Pra, ishte formuar një opozitë parlamentare ndonëse e pakonturuar dhe organizuar legalisht. Atëherë u akuzuan deputetët e Korçës për rrëzimin e kabinetit të S. Delvinës.<sup>3</sup> Në krye të opozicionit ishte anëtari i regjencës dhe i “Krahut Kombëtar”

<sup>3</sup> “Në qeveri tanë”, *Mbrojtja Kombëtare*, Vlorë, dt. 8 Shëndre 1920.

Aqif Pashë Elbasani i cili u fut në konflikt me figurën tjetër të rëndësishme të kësaj organizate dhe të qeverisë, A Zogun. Kështu krijimi i opozitës bëri një hap tjetër përpara dhe ky ishte cikli i dytë i përçarjeve në “Krahun Kombëtar”. Kjo ngjau edhe me Hoxha Kadriun i cili kishte qenë njëri ndër krerët më aktivë dhe me influencë të “Krahut Kombëtar”, e më në fund kryetar i kësaj organizate nën emrin e “Komitetit të Kosovës”. Ai kishte mbetur i pakënaqur pasi priste të bëhej kryeministër. Pakënaqësia e tij u shtua edhe më tepër kur ai kuptoi se simpatia e organizatës po shtohet gjithnjë e më tepër për Zogun, për shkak të sukseseve që ai kishte arritur si ministër i brendshëm.<sup>4</sup>

Sejfi Vllamasi pohon se Senati ishte ndarë në dy grupe. Grupi në shumicë që përfshinte anëtarët e “Krahut Kombëtar” dhe politikanë të tjerë me A. Zogun në krye. Mbështetës të këtij grupi ishin senatorët e Korçës, të Tiranës, të Dibrës dhe gjysma e atyre të Shkodrës. Ndërsa në grupin kundërshtar bënin pjesë senatorët e Vlorës, Beratit dhe të Gjirokastrës të cilët në shumicë influencoheshin nga Qazim Koculi.<sup>5</sup>

Në fillim të dhjetorit Senati u shpërnda. Pas kësaj kohe deri në dhjetor 1924 vendi do të kalonte një periudhë të gjatë krizash. Si pasojë e kontradiktave brenda qeverisë dhe Senatit, vendi kaloi në zgjedhje politike të cilat do të ishin zgjedhjet e para parlamentare demokratike në historinë e Shqipërisë.

Mbas dorëheqjes së S. Delvinës më 14 nëntor 1920 u vendos krijimi i një qeverie të re neutrale aq sa ishte e mundur në ato kushte dhe të caktohej një kryeministër që të gëzonte njëfarë besimi nga të dyja palët. Kryeministër u zgjodh Iljaz Vrioni, më i arsyeshëm dhe më i moderuar se bejlerët e tjerë. Qeveria u miratua me 17 vota pro dhe 4 kundër.<sup>6</sup> Pra, opozicioni numerik në Senat kundër saj ekzistonte, por ishte i reduktuar.

### **Veprimtaria e opozitës gjatë vitit 1921**

Nga krijimi i Parlamentit të parë Shqiptar më 21 prill 1921, e deri në dhjetor të vitit 1921, opozicioni nuk ka trajta të spikatura ashtu si edhe formacionet që mbështesnin qeverinë e Vrionit. Për këtë arsye, nuk ka ndonjë gjurmë të spikatur historike që të përshkruajë këtë veprimtari. Qeveria e Vrionit ishte një qeveri koalicioni dhe për këtë arsye opozicioni

<sup>4</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike.....*, f. 188-189.

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 215.

<sup>6</sup> *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, Viti I, 1920, f. 173-174, Mbledhja e 70-të më 15 nëntor 1920.

i hapur dhe legal kundër saj nuk kishte shfaqje. Por, kjo nuk do të thotë se në prapaskenë nuk vazhdonin intrigat dhe planet për përmbysjen e saj dhe krijimin e një qeverie, ku secila palë donte të qeveriste e vetme. Në parlamentin e ri u konturuan dy parti politike kryesore, “Partia Popullore” dhe “Partia Përparimtare”. Partia Popullore u krijua më 24 prill 1921 në pjesën më të madhe nga ish organizata “Krahu Kombëtar” që në atë kohë filloi të etiketohej në mënyrë kritike me emrin “Klika”. Pas Qazim Kokoshit kryetarë të kësaj partie do të bëheshin Fan Noli, Sejfi Vllamasi, Bedri Pejani dhe më pas A. Zogu. Partia përfaqësonte si mendimin konservator ashtu edhe atë liberal. Në shtator 1923, me largimin e mjaft figurave, dikur kryesore të saj, “Partia Popullore” mbeti tërësisht në duart e Zogut.

“Partia Përparimtare” e krijuar pak ditë më vonë përfshinte në gjirin e saj klasën e lartë të pronarëve të mëdhenj si Shefqet Verlacin e Iljaz Vrionin, Mehdi Frashërin etj. si dhe elementë kosovarë që vinin nga “Komiteti MKK” si Hoxha Kadri, që ishte kryetari i partisë, Hasan Prishtina, Bajram Curri etj.<sup>7</sup>

#### *Grusht-shteti i dhjetorit 1921*

Gjatë periudhës së marrë në studim, një qeveri e unitetit kombëtar, ishte edhe ajo e Pandeli Evangjelit, e cila u krijua në tetor të vitit 1921, si rezultat i bashkimit të dy partive kryesore. Kjo lëvizje politike bëri që posti i kryeministrit t’i kalonte “Partisë Popullore”, ndërsa qeveria ishte e kompozuar në mënyrë të barabartë midis të dyja partive. Në vend që të ishte një qeveri e fortë, fatkeqësisht rezultoi e kundërta. Kështu, u rrit kundërshtimi ndaj saj, por jo si një veprimtari normale opozitare por, si një konspiracion politik, i cili do të përfundonte me një grusht shteti. Interesant është fakti se, në fillim, komplotistët ndoqën një rrugë disi të çuditshme, ata eliminuan opozitën, ndonëse në një trajtë të përkohshme. Për të shpëtuar gjoja vendin nga përçarja, ata dolën me tezën demagogjike të bashkimit të partive e të grupeve, shkriren e tyre dhe krijimin në vend të tyre të “Grupit të shenjtë”. Nismëtarët u mbledhën në shtëpinë e Hasan Prishtinës dhe aty vendosën rrëzimin e qeverisë së Iljaz Vrionit dhe formimin e një kabineti me Mustafa Krujën e Luigj

<sup>7</sup> Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar: 1912-2005. Organizimi shtetëror, jeta politike, ngjarjet kryesore, të gjithë ligjvënësit, ministrat dhe kryetarët e shtetit shqiptar në historinë 93-vjeçare të tij*, Tiranë: 55, 2006, f. 131-133.

Gurakuqin. Shumë anëtarë të parlamentit e pranuan këtë “zgjidhje” dhe dy partitë u paralizuan.<sup>8</sup>

Krijimi i “Bashkimit të Shenjtë” dhe i qeverisë së Pandeli Evangjelit, e cila ishte produkt i saj, prodhoi një opozicion latent por tepër të fuqishëm dhe të rrezikshëm. Rrënjët e këtij opozicioni shtriheshin si në “Partinë Përparimtare” ashtu dhe në atë “Popullore”. Ky grup opozitar, në të cilin bënin pjesë: Aqif Pashë Elbasani, Zija Dibra, Qazim Koculi, Hasan Prishtina etj., kishte qenë iniciator i “Bashkimit të Shenjtë”, por kishin mbetur të pakënaqur nga rezultatet e tij. Forma e opozicionit që ata zgjedhën ishte ajo më e rrezikshmja, përmbysja e qeverisë me grusht shteti. Ky lloj opozicioni, në fillimet e jetës institucionale dhe parlamentare, ishte një rrezik i madh që do të kontaminonte marrëdhëniet politike jo vetëm për momentin por, edhe në të ardhmen.

Pas dështimit të grushtit të shtetit, më 24 dhjetor 1921, edhe kabineti “teknik” paraqiti dorëheqjen dhe Këshilli i Lartë ngarkoi Xhaferr Ypin të formojë qeverinë e re. Në të bënin pjesë Fan Noli (ministër i Jashtëm), Spiro Koleka (ministër i Punëve Botore), Ahmet Zogu (ministër i Brendshëm). Përveç grupit “popullor”, në këtë kabinet, tre vende iu dhanë “të pavarurve”. Pas grushtit të shtetit, Noli e pranoi dikasterin e jashtëm, por mbeti i pakënaqur dhe pakënaqësia e tij rridhte më tepër nga triumfi i kundërshtarit të tij, Sotir Pecit. Siç do të shohim më vonë, Noli do të largohej nga qeveria dhe do të kalonte në opozitë. Në ato kushte dhe për atë kohë, mund të thuhet se, kabineti ishte mjaft i mirë dhe mjaft homogjen. Ky ishte një shans i mirë për vijimin e procesit të stabilizimit.

Tashmë kemi daljen në skenë të një opozite të vërtetë dhe të formatuar në konture të qarta. Drejtuesit kryesorë të saj, ishin kundërshtarët e “Partisë Popullore” dhe të qeverisë Vrioni, shumica e të cilëve, filloi të vepronte hapur në suazat e Parlamentit. Në këto momente kritike, opozita, kishte pësuar një goditje të rëndë dhe ishte mjaft e dobët në Parlament. Një pjesë e saj do të dëbohej nga Parlamenti, si organizatore e grushtit të shtetit dhe e zgjedhur jo në rrugë konstitucionale. Pjesa më e madhe, mbeti brenda sistemit parlamentar por, tashmë kishte pësuar një goditje të rëndë politike dhe morale. Por, në vend që ta dobësonte, kjo situatë, do ta ashpërsonte edhe më tej qëndrimin e opozitës. Më tej u bënë zgjedhjet e

<sup>8</sup> Lidhur me grushtin e shtetit të dhjetorit 1921 shih: Albana Mema, “Situata në Shqipëri pas krizës së rëndë politike të vitit 1921 dhe kryengritjes së marsit 1922”, *Studime historike*, 3-4, 2014, f. 199-225.

reja, për të zëvendësuar deputetët e rrëzuar, si komplotistë për grusht shteti dhe në vend të tyre u zgjodhën politikanë që kishin mbështetjen e “Partisë Popullore”. Tani, “Partia Popullore” dispononte një shumicë dërrmuese në parlament. Por nga ana tjetër, duhet theksuar se me ngjarjet e vitit 1921, kemi edhe ndryshime brenda “Partisë Popullore” dhe madje edhe në radhët e organizatës “Krahu Kombëtar”, e cila përbënte boshtin e saj drejtues. Kështu, prej saj tashmë largohen përfundimisht dhe kalojnë në opozicion elementë shumë të fuqishëm si: Qazim Koculi, Aqif Pasha etj., të cilët do të forcojnë opozicionin, i cili siç theksuam, gjithsesi mbetet i dobët. Por ç’ka ishte më e rrezikshme, për shkak të pjesëmarrjes në grushtin e shtetit, ata do të shndërroheshin në krerë të opozitës jo legale dhe jashtë institucioneve shtetërore e politike. Ky do të ishte një rrezik i madh, si për pushtetin por, edhe për funksionimin normal të sistemit qeverisës dhe institucioneve të krijuara në bazë të Statutit të Lushnjës.

### **Aktiviteti politik i opozitës në vitin 1922**

Pas grushtit të shtetit, opozita nuk i moderoi qëndrimet e saj. Ishin një sërë rrethanash të cilat e shtynë në shkurt Bajram Currin, të niste në Pukë organizimin e një kryengritjeje, me qëllim përmbysjen e Zogut dhe imponimin e zgjedhjeve për Asambleshën Kushtetuese. Në fakt, pretendimi për mbledhjen e Asamblesës Kushtetuese, nuk mund të justifikonte goditjen me armë të rendit dhe institucioneve shtetërore. Historiografia e mëparshme është kapur shumë pas këtij argumenti, për të paraqitur si legjitime, kryengritjet dhe grushtet e shtetit që u organizuan në këtë kohë nga opozita.<sup>9</sup>

Në vitin 1922, opozita legale ishte në hapat e parë të një ballafaqimi ideor me konservatorët. Aktivitetet e saj përqendroheshin kryesisht në shtyp e Parlament dhe ajo ishte ende larg formimit të një platforme anti-zogiste. Në atë kohë Mit’hat Frashëri shkruante se, “prej opozitës Luigj Gurakuqi flet me logjikë dhe Koço Tasi me të matur”.<sup>10</sup> Kritikën e vazhdueshme opozitare, veçanërisht të gazetës “Dielli” e të shtypit katolik, bënë që qeveria të gjendej në vështirësi. Këto vështirësi do të bëheshin më evidente në vitin 1923.

<sup>9</sup> Lidhur me kryengritjen e marsit 1922 shih: po aty.

<sup>10</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 35, viti (më tej: V.) 1922, dosja (më tej: D) 24, fl. 7.

Nga pikëpamja gjeografike, opozita ishte përgjithësisht e fortë në Korçë, Gjirokastrë dhe Berat, për shkak të nacionalistëve të prirë nga Sulejman Delvina dhe në Shkodër ku liberalët e drejtuar nga Luigj Gurakuqi luanin një rol të madh.<sup>11</sup> Përveç tyre, në radhët e opozitës, bënin pjesë edhe disa bejlerë, të cilët nuk ishin të gatshëm për ndryshime të mëdha, e sidomos për reformë agrare, pasi ishin vetë pronarë. Parullat opozitare, ata i pranonin si një demagogji për të gjetur mbështetje kundër mazhorancës së Ahmet Zogut, të cilin e luftonin për rivalitet pozitiv dhe jo për mospajtime parimesh.<sup>12</sup> Pavarësisht prej faktit të këtyre afrimiteteve pragmatiste, opozita erdhi duke i forcuar pozitën e saj. Qëndrimet e mbajtura në Parlament nga eksponentë të opozitës së kohës, dëshmojnë fillimet e një tendence modernizuese dhe njëkohësisht, ishin dëshmi e një njohjeje të mirë të situatës shqiptare, por edhe të politikës së jashtme.

Ndërkohë, në këtë periudhë, ndarja midis forcave të brendshme politike, po kristalizohej më tej, duke u përqendruar në dy grupime me interesa e pikëpamje të kundërta. Në njërin anë, ndodhej krahu proqeveritar, shpesh i quajtur konservator, të cilët grumbulloheshin gjithnjë e më tepër rreth Ahmet Zogut, ndërsa në anën tjetër, grupi i Opozitës liberale, e cila në realitet nuk ishte e gjitha e tillë. Në kampin opozitar bënin pjesë ish-proteksionistët e kohës së armëpushimit, pasardhës të politikës proitaliane të qeverisë së Durrësit ku shquheshin Luigj Gurakuqi, demokratë radikalë si: Avni Rustemi, Stavro Vinjau, etj., dhe që në krye tashmë kishin Fan Nolin.

Noli u largua nga qeveria duke shënuar një cikël të ri të çarjeve brenda “Partisë Popullore” dhe “Krahut Kombëtar”. Kalimi i Nolit dhe grupit të tij në opozitë, e fuqizoi atë, madje edhe më shumë se kaq. Kjo pati një rëndësi të madhe, pasi i shtoi asaj një element dhe fizionomi shumë më të spikatur liberale. Fan Noli, pasi dha dorëheqjen si ministër i Punëve të Jashtme nga qeveria e parë e Xhaferr Ypit dhe pasi u likuiduan lëvizjet e Elez Isufit me shokë, u largua edhe nga “Partia Popullore”, bashkë me dy shokët e tij vatanë, Kristo Kirkën dhe Loni Kriston, pa e justifikuar largimin e tyre. Pak kohë pas largimit të Nolit, edhe deputetët e Gjirokastrës, S. Delvina, S. Vinjau, B. Omari, A. Këlcyra, R. Babameto

<sup>11</sup> Albert Mousset, *Shqipëria përballë Evropës*, Tiranë: Dituria, 2004, f. 50.

<sup>12</sup> Abaz Ermenji, *Vendi që ze Skenderbeu në Historinë e Shqipërisë*, Tiranë: Çabej, 1996, f. 404.

dhe Agatokli Xhitoni kaluan në opozitë. Ata pohuan se largoheshin nga “Partia Popullore”, ngaqë nuk mund ta duronin Zogun si ministër të Brendshëm. Por siç nënvizon Vllamasi, në atë kohë Zogu nuk kishte fuqi të madhe në dorë pasi ushtria dhe xhandarmëria ishin në duart e anëtarëve të tjerë të “Partisë Popullore”. Nga ana tjetër, “Zogu që nga Kongresi i Lushnjes deri në shtypjen e kryengritjeve të fundit i kishte bërë shërbime të mëdha vendit, duke zbatuar në një mënyrë të përpiktë vendimet e partisë së tij. Ai ishte një njeri i krijuar për atë situatë dhe ka qenë tepër i nevojshëm për një parti që kishte marrë përgjegjësinë e stabilizimit të shtetit. Duhet nënvizuar se në veprimet e tij kishte respektuar ligjin dhe kushtetutshmërinë. Madje edhe në ngjarjet e grushtit të shtetit 1921 ai ishte bërë garant i kushtetutshmërisë. S. Vllamasi thekson se pretendimi i këtyre elementëve për largimin nga ‘Partia Popullore’, për arsye të prezencës së Zogut, ishte vetëm një pretekst justifikues”.<sup>13</sup> Shpjegimet e Vllamasit, sado me rezervë që të merren, na çojnë në përfundimin se kjo përçarje e “Partisë Popullore” dhe krijimi i këtij fraksioni opozitar, nuk erdhi si shkak i problemeve parimore apo të keqqeverisjes, por për arsye të egos personale dhe kjo është një provë tjetër, e naivitetit dhe foshnjërisë, së forcave politike të asaj kohe dhe, në këtë kontekst edhe të fraksionit që drejtonte Noli. Gjithsesi duhet pasur parasysh edhe fakti se sukseset e Zogut e kishin bërë atë shumë të fuqishëm brenda partisë. Kështu disa nga kolegët e tij nuk ishin të gatshëm ta pranonin këtë hegjemoni të tij.

Në dhjetor 1922, A. Zogu mori postin e kryeministrit. Kjo ngjarje do ta përforconte më tej opozitën kundër tij. Duke e analizuar këtë fenomen diplomatik britanik R. Parr do të shkruante, më 15 tetor 1923, se pas marrjes së postit të kryeministrit nga Zogu, “Rrymat e nënkuptuara se mbështeteshin nga Italia e Jugosllavia dhe rivendosja e marrëdhënieve mes Gurakuqit dhe mbetjeve të gjysmës së ‘Klikës’- një rivendosje e marrëdhënieve në të cilën, ky i fundit shpresonte të përdorte të parën, si një shkallë për të marrë fuqinë, gradualisht, kristalizuan më tej opozitën ndaj tij.”<sup>14</sup>

Në fushën legjislative, lufta politike u përqendrua, jo aq në çështjen e zëvendësimit të ligjeve të vjetra (për këtë ishin të një mendjeje në përgjithësi, si shumica qeveritare ashtu edhe opozita), se sa në

<sup>13</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 284.

<sup>14</sup> *The British National Archives (TNA)*, Foreign Office (më tej: FO) 371/8535, f. 1148-1149, Telegram i Parr për Curzon, mbi situatën politike në Shqipëri, 15 tetor 1923.

përbajtjen e ligjeve të reja. Në këtë çështje, opozita ishte orientuar qartë dhe vendosmërisht nga përvoja e legjislacionit demokratik perëndimor që “të shkulemi nga Orienti”, sikurse shprehej Stavro Vinjau. Ndërsa deputetët proqeveritarë, ishin të prirur për të frenuar këtë përtëritje demokratike të legjislacionit. Debati parlamentar në Kuvend, në përgjithësi, u karakterizua nga lufta e ashpër politike, njësoj si dhe në “Këshillin Kombëtar”. Opozita përdorte forma të ndryshme presioni si braktisja e punimeve gjatë një seance, sikurse ndodhi në legjislaturën e fundit ku kishte përdorur edhe taktikën e obstrukcionizmit gjatë diskutimit të projektligjit të zgjedhjeve. Pra, edhe në Shqipëri filluan të gjejnë zbatim ato forma lufte e proteste, që njiheshin prej kohe në praktikën e parlamenteve të vendeve të tjera.

### **Opozita në zgjedhjet e vitit 1923**

Në verën e vitit 1923 opozicioni kundër politikës së qeverisë së Zogut u rrit në përmasa kritike. Zjarrin kësaj vale të re të opozitarizmit ja vuri çështja e koncesionit të vajgurit. Fuqitë e huaja të interesuara ndërhyjnë secila për interes të vet, duke i dhënë opozicionit trajtën e një konflikti të rrezikshëm politik. Komisioni Hetimor i LK zbulonte edhe lojën që luajti opozita, në bashkëpunim me Spiro Kolekën, në çështjen e koncesioneve për vajgurin dhe motivet e saj. Komisioni i LK pohonte: “Mund të jetë interesante të shohësh rolin që ka pasur çështja e vajit në ngjarjet politike të muajve të kaluar. Në fillim, Spiro Koleka, ministri i atëhershëm i Punëve Publike, e bllokoi koncesionin për shoqërinë “Anglo-Persiane”, kryesisht për arsye të interesave personale të tij. Për këtë arsye, duke u bërë e qartë se qeveria kishte si qëllim ta kalonte masën, legata italiane, franceze dhe ajo amerikane formuan një front solid dhe hapur u radhitën në krah të partisë së Gurakuqit, i cili ishte opozita zyrtare. Gradualisht, të gjitha partitë, panë se pas çështjes së koncesionit varej kohëzgjatja në pushtet e A. Zogut. Opozicioni politik i brendshëm ndaj kësaj qeverie, u fuqizua dukshëm nga forcat e jashtme që u vunë në lojë dhe A. Zogu nuk ishte asnjëherë krejtësisht i sigurt për mbështetësit e tij. Ishte influenza politike e tmerrshme, që vinte nga të gjitha anët, shoqëruar me bllokimin e Shqipërisë nga të tre legatat, të cilat, të shoqëruara edhe me dyshimin e disa deputetëve dhe anën ekonomike të çështjes, sollën tërheqjen e A. Zogut”.<sup>15</sup>

<sup>15</sup> *Po aty.*

Ky është një konstatim sa i saktë, aq edhe me vlerë, për të arritur një konkluzion rreth bashkëveprimit të forcave opozitare me faktorë të huaj, si dhe për të nënvizuar një tipar tjetër të opozitës por, edhe të grupeve të ndryshme politike në pushtet apo jashtë tij. Ky tipar, ka të bëjë me bashkimin e interesave politike të një grupi të caktuar me ato të shteteve të ndryshme, pa marrë parasysh interesat themelore dhe jetike të vendit, të cilat në çështjen e koncesioneve dhe në çështjet e tjera, duhet të prevalonin mbi të gjitha interesat e tjera. Ky ishte një defekt i rëndë i politikës së kohës, i cili, duket se edhe sot nuk është kapërcyer.

Që në verën e vitit 1923, britanikët zbuluan se, po përgatitej edhe një grusht shteti nga një pjesë e opozitës. Nën titullin: “Një *Coup* nacionalist i projektuar në Shqipëri”, Përfaqësia britanike në Durrës, informonte Londrën se, një komitet i ri revolucionar shqiptar ishte formuar në Vjenë, nën drejtimin e Aqif Pashës, “i cili po planifikon të rrëzojë qeverinë aktuale përpara zgjedhjeve të tetorit dhe të vendosë në vend të saj një qeveri me në krye Aqif Pashën dhe Hasan Bej Prishtinën.” Sipas britanikëve, komplotistët kishin shtrirje edhe në parlamentin shqiptar. “Agjenti drejtues i komitetit në Shqipëri është Fan Noli, peshkopi nga Tirana.” Ndërsa thuhet se, “Hasan Bej Prishtina po përpiqej të mblidhte malësorët nga malet shqiptare”. “Komiteti, pohonin diplomatët britanikë, është i sigurt për suksesin e tij. Ai propozon vendosjen e monarkisë dhe ofrimin e koncesionit të benzinës Shteteve të Bashkuara dhe Anglisë si karrem për njohjen”.<sup>16</sup>

Gjithashtu, edhe diplomati britanik, Eyres, përshkruante pozitën e Aqif Pashës dhe të pjesëtarëve të tjerë të këtij Komiteti revolucionar, siç e quante ministri britanik. Ai informonte Sekretarin e Jashtëm, Curzon: “Aqif Pasha, është tërësisht i lirë për t’u kthyer në Shqipëri, kurdo që të ketë dëshirë, por krenaria e tij nuk e lejon një gjë të tillë, për sa kohë që kundërshtarët e tij janë në fuqi.”<sup>17</sup> Për pjesëtarin tjetër të këtij komiteti ai shprehej: “Zia Dibra, mendoj se në realitet nuk është një shqiptar, por një agjent qemalist, i cili për shkak të të qenit në shërbimet turke, u vu pa një arsye, Ministër në qeverinë e Pandeli Evangjelit dhe për këtë arsye e prishi totalisht balancën e saj.”<sup>18</sup> Më tej, ai fliste edhe për pjesëtarin tjetër

<sup>16</sup> TNA, FO 371/8535, f. 1120-1122, Telegram për FO, në lidhje me një *Coup* nacionalist të projektuar në Shqipëri, Durrës, 20 korrik 1923.

<sup>17</sup> TNA, FO 371/8535, f. 1133-1136, Telegram i Eyres për Curzon, mbi komitetin revolucionar në Vjenë, 27 gusht 1923.

<sup>18</sup> *Po aty*.

të këtij komiteti, Fan Nolin, i cili ishte i vetmi nga pjesëtarët e përmendur, anëtar i Parlamentit. Eyres shkruante: “Fan Noli është anëtar i opozitës dhe me shumë mundësi ka komunikim me cilindo dhe çfarëdo kombinacioni që i ofron atij mbështetje, po ai vetë nuk ka influencë jashtë Parlamentit.” Ndërsa, për Hasan Bej Prishtinën pohonte se, ishte “akoma një i arratisur i fuqishëm në malet e veriut dhe të lindjes.”<sup>19</sup>

Për Eyres-in, ishte e vështirë të kuptohej pse Aqif Pasha fliste për influencën jugosllave në Shqipëri. Në qoftë se ai do të ishte një partizan proitalian, do të ishte e kuptueshme, por Pasha duhet ta dinte se A. Zogu kishte pasur vështirësi të konsiderueshme për të mbajtur një situatë të marrëdhënieve të mira me Jugosllavinë dhe sugjerimi se Jugosllavia ka një influencë mbizotëruese mbi qeverinë, konsiderohej prej ministrit britanik, “absolutisht pa baza”. Eyres gjykonte se qëllimet e komitetit, siç u përshkruan më sipër, ishin kontradiktore me ato që ai proklamonte, përdërisa qeveria e Zogut përmbushte qëllimet e afishuara prej tij. Ndërsa, pikat e tjera si: forma e qeverisjes dhe sjellja politike ndaj vendeve të tjera, do të vendoseshin nga Asambleja Kushtetuese. Eyres nënvizonte kursin e balancuar të politikës së Zogut. Lidhur me këtë ai shkruante: “Duke u përpjekur të mbante një vijë të mesme, për ta mbajtur Shqipërinë të pastër nga të gjitha mashtrimet (e shteteve të interesuara), Ahmet Zogu ka shkaktuar armiqësinë e mjaft të huajve dhe dashamirësinë e asnjërit në Evropën Jugore.”<sup>20</sup> Eyres e kishte diskutuar, mesa duket, çështjen e komitetit të Vjenës me Zogun. Ky i fundit mendonte se, “njerëz të tillë nuk ishin të aftë ta dëmtonin Shqipërinë dhe ai e shihte me mospërfillje komplotin e Vjenës”. Por, vetë Eyres mendonte se vetëbesimi i Kryeministrit, ishte jo i bazuar. Ai ishte i shqetësuar “për shkak se armiqtë e qeverisë janë të shumtë dhe intrigat e huaja po e ngrenë kokën”.<sup>21</sup>

Përfaqësuesi britanik Eyres, e gjykonte në këtë mënyrë, situatën në prag të fillimit të fushatës zgjedhore, më 26 gusht 1923. Ndërsa, njoftonte se në këtë kohë, Dhoma e Deputetëve ishte në sesion të veçantë, i cili do të diskutonte dhënien e koncesioneve dhe kalimin e ligjit të zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, Eyres pohonte: “Është pothuajse e pamundur të parashikosh rezultatin e zgjedhjeve, por është e qartë se disa

---

<sup>19</sup> *Po aty.*

<sup>20</sup> *Po aty.*

<sup>21</sup> *Po aty.*

kundërshtarë të qeverisë, mendojnë se janë duke fituar fuqi dhe qeveria nuk ka vepruar në mënyrë të tillë, që të bëjë për vete zgjedhësit e lëkundur dhe administrimi i saj në provinca, nuk ka qenë aq i drejtë, sa të fitojë të votën e tyre. Nga ana tjetër, janë një numër i madh zgjedhësish që preferojnë personalitetin e Ahmet Zogut, ndaj çdo pasardhësi të mundur të tij”. Por, më i rëndësishëm ishte informacioni që jepte diplomati britanik, për reagimin e popullsisë ndaj fjalimeve të liderit më parimor dhe demokrat të opozitës, F Nolit: “Në Bilisht, ai kërkoi opinionet mbi programin e tij. Dhe përgjigja ishte: “Jetë të gjatë qeverisë së Ahmet Zogut dhe vdekje armiqve të tij”. Ai u prit keq edhe në dy qytete të tjera.” Megjithatë, Eyres mendonte se, opozita po fitonte terren drejt suksesit, por, gjithsesi, shtonte ai, situata ishte “shumë e errët për të pranuar këtë profeci.”<sup>22</sup>

Në vjeshtën e vitit 1923, në prag të zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, ndodhi një përçarje e re në “Partinë Popullore”, e cila mori edhe trajtën e një grushti shteti në tentativë. Kjo forcoi shumë opozitën dhe dobësoi qeverinë dhe partinë e shumicës - “Partinë Popullore”. Nga hulumtimet e deritanishme na rezulton se Zogu kishte kohë që ishte në mosmarrëveshje me një grup të konsiderueshëm politikanësh të Krahut Kombëtar ose të “Klikës” si po etiketohej gjithnjë e më shumë kjo organizatë në atë kohë. Në verën e vitit 1923 ai vendosi të ballafaqohej me ta. Kështu lindi një përçarje e re e thellë brenda “Partisë Popullore”. Kështu, ai vendosi të largohej nga “Krahu Kombëtar”, pikërisht nga përçarja krejt e paarsyeshme e partisë së tij dhe kalimi i një pjese të saj drejt opozitës. Kjo ishte një lëvizje e detyruar, e cila, jo vetëm diktohej nga vetëmbrojtja e Zogut nga rreziku që i kanosej për jetën e tij por, edhe nga sigurimi i lirisë për të themeluar një forcë tjetër politike të disiplinuar, për të marrë në dorë qeverisjen e vendit. Sigurisht, Zogu shpresonte se do të kishte edhe mbështetjen e shumicës së kolegëve dhe shokëve të tij të “Krahut Kombëtar”.

Nga ky konflikt që deri në verën e vitit 1923 po zhvillohej në heshtje opozicioni dukej se po rritej. Opozita, zhvilloi një luftë të ashpër politike kundër qeverisë në Parlament, e cila ishte e kombinuar me luftën që bënte F. Konica me anën e gazetës “Dielli”, me luftën që bënte “Shqiptari i Amerikës” që botohej në Korçë, nën drejtimin e Loni Kristos, deputet i

<sup>22</sup> TNA, FO 371/8535, f. 1139-1140, Telegram i Eyres për Curzon mbi ngjarjet në Shqipëri, 26 gusht 1923.

Korçës, si dhe me atë që bënte gazeta “Ora e Maleve”, e cila botohej nga kleri katolik në Shkodër.<sup>23</sup> Krahas tendencave liberale dhe progresive, veprimtaria e opozitës kishte edhe elementë të paarsyeshëm denigrimi.

Historiografia e periudhës së mëparshme, e ka vlerësuar “Partinë Popullore” që po qeveriste vendin, si qeverisje të bejlerëve konservatorë dhe opozitën si të përbërë vetëm nga intelektualë progresistë, por në opozicionin kundër qeverisë bënë pjesë edhe shumë bejlerë. S. Vllamasi pohon se, “bejlerët në përgjithësi e sidomos bejlerët e mëdhenj, nuk mund të duronin që “Krahu Kombëtar”, i përbërë gati krejtësisht prej elementëve jo të rangut të tyre, të sundonte shtetin duke qenë ata gjallë”.<sup>24</sup> Sigurisht, duhen marrë me rezervë këto vlerësime kontradiktore, duke u përpjekur të zbulojmë se deri ku ato janë të vërteta. Në fakt, “Partia Popullore” nuk ishte as kaq përparimtare dhe liberale, siç thotë Vllamasi dhe as aq konservatore dhe vegël e bejlerëve, siç është paraqitur më parë. Nga ana tjetër, as opozita nuk ishte e gjitha destruktive dhe konservatore, siç e përshkruan Vllamasi por dhe jo e gjitha liberale dhe progresive, siç e ka paraqitur historiografia e periudhës komuniste.

Por nga ana tjetër opozita vijonte të kishte një sërë dobësish të theksuara politike e organizative. Mangësitë e opozitës dhe opozicionit i ka evidentuar edhe studiuesi Robert Austin. Në lidhje me të, ai shkruan: “pushteti i Zogut ishte në rritje dhe ai vetë po respektohej nga bota e jashtme, si i vetmi politikan shqiptar që ishte në gjendje të ruante stabilitetin e brendshëm. Ndërsa pushteti i Nolit po binte dhe nga marsi i vitit 1922, ai u pa se ishte një forcë politike e lodhur”.<sup>25</sup> Austin më tej, thekson se: “Faktet provojnë se, Noli, i cili në të vërtetë ka qenë ylli demokrat i opozitës laramane të asaj kohe, nuk ishte as një politikan dhe as një opozitar i vendosur në angazhimin e tij politik. Kështu, në një moment ai vendosi të tërhiqej nga jeta politike dhe t’i kushtohej sërish punëve të kishës. Por pak më vonë, për shkak të rritjes së pakënaqësisë në jug, Noli që ishte në rivalitet me Zogun, por edhe për shkak të presionit që iu bë nga Faik Konica, ai u kthye nga mënjanimi i vetë imponuar për të sfiduar Zogun dhe në shtator 1923 krijoi partinë liberale me qendër në Korçë. Më në fund ai u shfaq si organizatori kryesor i forcave liberale kundër Zogut”.<sup>26</sup> Pra, segmenti kryesor, më progresiv dhe pozitiv i opozitës, nuk

<sup>23</sup> *Po aty*, f. 306.

<sup>24</sup> *Po aty*, f. 324.

<sup>25</sup> Robert Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, Tiranë: Albin, 2003, f. 53.

<sup>26</sup> *Po aty*, f. 58.

ishite i mirëorganizuar dhe nuk kishte ndërtuar në mënyrë serioze dhe të qëndrueshme profilin e vet politik. Gjithashtu, ky segment, nuk arriti të përpunonte një program dhe strategji të qartë politike, e cila të ishte udhëheqëse me veprimtarinë e tij opozitare.

Ndërsa, për sa i përket grupeve të tjera të opozitës, me shumë të drejtë, Austin është edhe më kritik. Këto grupe nuk kishin as një profil më liberal dhe as një program reformues për vendin. I vetmi qëllim ishte përmbysja e qeverisë dhe marrja e pushtetit.

Në tetor 1923, Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve, bënte një analizë tepër interesante për formimin dhe ecurinë e opozicionit në Shqipëri. Në një nga raportet e tij thuhej: “Kur u formua ‘Klika’ (Krahu Kombëtar), e cila tashmë kontrollonte ‘Partinë Popullore’, ajo përbëhej nga një numër i madh anëtarësh të klasave intelektuale të jugut të Shqipërisë, e përforcuar nga elemente të tjerë nën udhëheqjen e Kadri Hoxhës nga Shkodra, Bajram Currit, Hasan Prishtinës dhe të tjerë, udhëheqës që kanë luajtur një rol të caktuar në politikë, gjatë 10-15 viteve që shkuan. Opozicioni ndaj ‘Partisë Popullore’ erdhi nga këto cikle, të cilët ndoqën një rrugë, në të cilën, Shqipëria nuk mund të qëndronte, përveç se nën tutelën direkte të Fuqive të huaja. Mosmarrëveshjet në ‘Klikë’, të cilat fillimisht morën formë në tetor të 1921 dhe kulmin e patën në kryengritjen e marsit në vazhdim, e lanë ‘Klikën’ të zhveshur nga gjithçka, por anëtarët e saj të jugut iu rikthyen gjerësisht çështjes së Kosovës”.<sup>27</sup>

Pra, siç e kemi theksuar edhe më lart, krijimi i opozicionit erdhi përmes disa cikleve. Bërthama e parë kishte qenë grupi i politikanëve që kishin qenë mbështetës ose pjesëtarë të qeverisë së Durrësit dhe që u lanë jashtë përfaqësimit politik ose qeverisjes nga Kongresi i Lushnjës. Të tillë ishin: M. Kruja, L. Bumçi, M. Libohova etj. Më tej opozicioni u pasurua me grupin e politikanëve kosovarë, irredentizmi i të cilëve i çoi në opozicion me politikën e moderuar të qeverive të kohës. Në këtë grup bënin pjesë: Hasan Prishtina, Hoxhë Kadriu, Bajram Curri etj. Ky grup ishte edhe cikli i parë i shthurjes së “Krahut Kombëtar”, e cila kishte qenë organizata dominuese në Kongresin e Lushnjës. Pra, fenomeni i irredentizmit ishte nxitje për krijimin e një segmenti të fortë opozitar.

<sup>27</sup> TNA, FO 371/8535, f. 1148-1149, Telegram i Parr për Curzon, mbi situatën politike në Shqipëri, 15 tetor 1923.

Duke e trajtuar më gjerësisht këtë çështje, diplomati britanik R. Parr, më 15 tetor 1923, njoftonte Forin Offisin: “Eshref Frashëri dhe jugu mendonin se Shqipëria do të ishte më mirë të shpenzonte pak a shumë 10 vjet në vendosjen e rregullit në shpinë e saj dhe pastaj të vendoste rihapjen e çështjes së Kosovës. Edhe A. Zogu iu bashkua këtij mendimi. Nga ana tjetër, Bajram Curri, Hasan Prishtina dhe të tjerë, ndoqën rrugën me të cilën, me intrigat direkte apo indirekte, kundra Jugosllavisë, mund të arrinin ta fitonin Kosovën më shpejt. Kjo sjellje, natyrisht i hodhi në duart e Italisë dhe ata kishin shumë gjëra të përbashkëta me partinë e Gurakuqit”.<sup>28</sup>

Parr, shtonte se më tej kishte ndodhur Kryengritja e Marsit 1922 dhe opozita ishte pasuruar me një grup të ri që ishte shkëputur nga “Partia Popullore”. Ky grup kishte në krye F. Nolin dhe mbështetësit e tij, K. Kirka, S. Vinjau, B. Omari, etj.

Në kohën kur një ndarje e dytë ndodhi në ‘Klikë’ dhe Kolonel Tatzati, ministri i Luftës, Bedri Pejani, Ali Koprencka, Halim Gostivari dhe tre persona të tjerë u deklaruan kundër Zogut, ky i fundit u sulmua se ishte shumë miqësor me Jugosllavinë dhe se kishte dështuar në reformimin e administratës së brendshme. Kur e gjetën veten të pazotë për ta hequr atë nga posti i presidentit të Këshillit ose nga Ministria e Punëve të Brendshme, ata u shkëputën (nga Partia Popullore). R. Parr informonte Londrën se “këtu ka arsye për të dyshuar mbi influencën italiane”.<sup>29</sup> Kjo është një paraqitje sintetike dhe mjaft korrekte e ecures së opozitës dhe opozicionit në Shqipëri. Në qendër vendoset fraksionizimi i herëpashershëm dhe përçarjet në “Krahun Kombëtar”, të cilat formësuan opozicionin, që nga viti 1921 e në vazhdim.

Afrimi i zgjedhjeve për në Asamblenë Kushtetuese e inkurajoi edhe më shumë luftën politike të saj. Sërish ndodhi një çarje e re e “Partisë Popullore” dhe e “Klikës”, e cila dobësoi qeverinë në një moment kritik, kur Parlamenti ishte shpërndarë dhe zgjedhjet ishin në prag. Nga ana tjetër, kjo çarje forcoi më tej opozitën duke krijuar një ekuilibër të ri politik në Shqipëri. Edhe kjo çarje e re u shoqërua me tension politik dhe tentativën për një grusht të ri shteti.

Vetëm në vjeshtën e vitit 1923, kundërshtarët e Zogut patën rastin e parë ligjor që të kundërshtonin pozitën e tij, kur më në fund u thirrën

<sup>28</sup> *Po aty.*

<sup>29</sup> *Po aty.*

zgjedhjet për të shumëpriturën Asamble Kushtetuese. Të shtyra herë pas here, zgjedhjet ishin caktuar të vendosnin çështjet themelore të strukturës së shtetit. Raundi i parë i votimit do të zhvillohej në shtator dhe i dyti në dhjetor. Asambleja Kushtetuese do të funksiononte edhe si parlament dhe do të hartonte një kushtetutë të re që do të zëvendësonte Statutin e Kongresit të Lushnjës. Lloji i qeverisjes, republikë apo monarki, ishte problem qendror. Mbas plotësimit të këtij plani, Asambleja duhej të jepte dorëheqjen para se të mbaheshin zgjedhjet e reja për një parlament të rregullt.<sup>30</sup>

Në pragun e zgjedhjeve ndodhi një zhvillim i ri pozitiv brenda radhëve të opozitës. Për shkak të rritjes së pakënaqësisë në Jug dhe presionit nga Faik Konica, Noli që ishte në rivalitet me Zogun, u kthye nga mënjanimi i vetëimponuar, për të sfiduar Zogun dhe në shtator 1923, krijoi “Partinë Liberale” me qendër në Korçë. Më në fund, Noli u shfaq si organizatori kryesor i forcave përparimtare të Jugut, rreshtuar kundër Zogut. Opozita besonte se votimi direkt ishte më demokratik dhe do të siguronte, jo vetëm një Asamble më përfaqësuese, por edhe fitoren e tyre, duke i dhënë fund korrupsionit në raundin e dytë. Me anë të votës së lirë dhe direkte, deklararin progresistët, masat fshatare do të dëbonin shtypësit e tyre. Me dyshime të thella për sistemin indirekt, progresistët e grumbulluar rreth Nolit, kërkuan imponimin e një ligji të ri elektorale, që do të zëvendësonte rregullat e dhjetorit 1920, të cilat, parashikonin që zgjedhjet të bëheshin në dy raunde.

Struktura politike, e krijuar pas zgjedhjeve të vitit 1921, e përfaqësuar nga “Partia Popullore” dhe “Partia Përparimtare”, u bë e shumëllojshme dhe u shfaqën forca të reja. Jugorët të prirur ndaj reformave dhe bashkësia katolike në krahinën e Shkodrës dolën sheshit me organizata të reja, duke shpresuar të largonin ndikimin e mbeturinave të “Partisë Popullore” dhe “Partisë Përparimtare”. Zogu, që ashtu si Noli, kishte qenë anëtar i “Partisë Popullore”, zgjodhi të mos bashkohej me politikanët pro reformave dhe krijoi një lloj partie të qeverisë. Siç ndodhte shpesh në të kaluarën, Zogu e shpalli veten garantues të rendit dhe stabilitetit. Opozitarët e krahut progresist përparimtar të vendit, të dalë nga shoqëria “Bashkimi”, mbështetës të “Vatrës” dhe ish anëtarë të “Partisë Popullore”, paraqitën një sërë programesh. Përfundimisht, këto grupe bënë fushatë të përbashkët si “Parti e Opozitës” ku futeshin

<sup>30</sup> R. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit ...*, f. 64-66.

“Liberalët” e Nolit, “Demokratët” me bazë në Gjirokastrë, “Ora e Maleve” nga Shkodra dhe Nacional-Demokratët me bazë në Vlorë. Shoqëria “Bashkimi”, që dukej qartë se s’ ishte parti politike, nuk paraqiti kandidatë, ndonëse udhëheqësi i saj, Avni Rustemi ishte kandidat në prefekturën e Kosovës (Kukës). Edhe pse historiografia komuniste, ka fajësuar për mungesën e unitetit të opozitës borgjezinë e pazhvilluar shqiptare,<sup>31</sup> realiteti ishte më i komplikuar. Krahinarizmi ishte ndoshta problemi më i madh, sepse “opozita ishte një mish-mash grupesh që nuk kishin mbështetje tjetër përtej fesë përkatëse dhe zonave të tyre elektorale”.<sup>32</sup>

Divergjencat e thella në mesin e vetë përparimtarëve, ishin pengesa kryesore për rrëzimin e Zogut. Për më tepër, këto grupe kishin dalë vetëm me thirrjen për Asamblenë Kushtetuese dhe asnjë prej tyre nuk kishte më shumë se sa një ndikim të sipërfaqshëm. “Liberalët” e Nolit, kërkonin: mbajtjen e Këshillit regjent prej katër vetash, të drejtën e votimit të fshehtë, pavarësi të plotë të gjykatës, një kushtetutë që garantonte liritë themelore të fjalës, shtypit dhe pronës, garanci kushtetuese kundër diktaturës, parimet perëndimore në qeverisje dhe thjeshtim të burokracisë qeveritare. Për sa i përket llojit të qeverisjes, liberalët mendonin se kjo duhej të vendosej nga populli shqiptar me referendum. “Demokratët” kishin një program të ngjashëm që kërkonte reformë të fuqishme agrare dhe luftë kundër ideve monarkiste.

Po të analizohen programet elektorale, me përjashtim të diferencave për sistemin e votimit apo mendimeve të ndryshme se si duhej realizuar një reformë agrare të cilat deri në këtë kohë ishin artikuluar në mënyrë të turbullt dhe jo si problem madhor e esencial imediat social-politik, nuk kishte ndonjë dallim tjetër thelbësor midis programit të partisë qeveritare të drejtuar nga Zogu dhe grupeve kryesore të opozitës. Ky afrimitet i programeve, duhej të shërbente si një bazë e fortë për marrëdhënie normale dhe relativisht të çtendosura midis opozitës dhe shumicës. Por, ky pohim, vlen vetëm për vendet me një demokraci të konsoliduar dhe jo për Shqipërinë e saj kohe, e cila ishte shumë larg kësaj faze. Marrëdhëniet midis grupeve politike në pushtet dhe në opozitë përcaktoheshin, jo nga

<sup>31</sup> Hilmi Veterniku, “Problemi i Asamblesë Kushtetuese dhe zgjedhjet e vitit 1923”, në *Studime historike*, nr. 4, 1968, f. 121.

<sup>32</sup> R. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit* ....., f. 58.

problemet programore parimore, por nga interesat, aspiratat dhe pakënaqësitë personale në betejën për pushtet.

Që prej fillimit të procesit zgjedhor për Asamblenë Kushtetuese, e deri në qershor të vitit 1924, terreni politik shqiptar ishte i tensionuar, me akuza e kundëraakuza të ndërsjellta. Kjo situatë, përveç konkurrencës për pushtet, radikalizoi opozitën. Kjo u reflektua në shtyp, ndër komunikatat e grupimeve politike në Parlament etj. Parullat politike të kësaj kohe janë ndër më interesantet dhe shpeshherë më radikale të periudhës ndërmjet viteve 1920-1924. Debati më i nxehtë në këtë periudhë përqendrohej në çështje të tilla si: problematika zgjedhore, Statuti i Shtetit dhe zhvendosja e kryeqytetit. Të tre çështjet u shfrytëzuan maksimalisht nga opozita, si “mjeshtrë e fjalës” në Parlament.

#### *Opozita pas zgjedhjeve- fillimi i konfliktit politik*

Pas zgjedhjeve, pamundësia e formimit të një qeverie homogjene, krijoi një situatë shqetësuese. Nga ana tjetër, vlonte propaganda e përçarjeve krahinore e fetare në formë të organizuar. S Vllamasi pohon se kjo ishte e qëllimshme “për të shkaktuar anarki mendimesh, sidomos midis elementit të padjallëzuar dhe të elementit që nuk kish njohuri të vërteta mbi qëllimin e kësaj propagande”. Është për t’u shënuar fakti se, partikularizmat krahinore dhe fetare, ashtu si dhe më parë, në rastet e qeverisjes së fortë dhe efektive, krijonin imazhin e një fenomeni të fjetur, të shtypur e të tejkaluar, por në rastin e krizave të rënda politike, ato dilnin në shesh, me gjithë forcën e tyre shkatërrimtare, duke e vënë unitetin kombëtar dhe institucionet e brishta shtetërore, në rrezik serioz për ekzistencën e tyre dhe duke i demoralizuar ato.

Radikalizmi i veprimeve të opozitës, erdhi nga përcaktimi i saj, për të ardhur në pushtet me çdo kusht edhe duke sfiduar ligjet dhe mjetet legale. Studiuesi Arben Puto, përpiqet të argumentojë qëndrimin radikal të opozitës, me diferencën e ngushtë të votave midis saj dhe qeverisë. Por ky nuk duket një argument i qëndrueshëm. Puto shpjegon se, “diferenca e ngushtë midis votave në favor të qeverisë dhe atyre në favor të opozitës, në zgjedhjet e dhjetorit 1923, u bë shkak për rritjen e tensioneve midis tyre. Zogu u përpoq të shfrytëzonte postin e Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm për ta mbajtur nën kontroll situatën...”.<sup>33</sup> Këtu bie qartë në sy, përsëritja identike e pikëpamjes së vjetër të historiografisë së mëparshme,

<sup>33</sup> Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 345.

që justifikon qëndrimin e opozitës, madje edhe vrasjet politike të nxitura nga drejtues të saj. Zogu nuk mund të jepte dorëheqjen, pa u formuar më parë një mazhorancë, e cila do të shpallte se do të formonte qeverinë e re. Kjo për arsyen e thjeshtë se vendi mund të rrëshqiste në anarki. Gjithashtu, kjo nuk ishte një sfidë ndaj opozitës, siç e ka interpretuar Puto dhe aq më pak kjo nuk e justifikon vrasjen politike të organizuar kundër kryeministrit. Ky është një moment kyç, që duhet interpretuar drejt nga ana historike. Duhet analizuar me kujdes karakteri ligjor i veprimeve të opozitës dhe shkaqet e gjithë ngjarjeve që ndodhën më pas.

Studiuesja Aurela Anastasi e ka shpjeguar kështu radikalizmin e veprimeve të opozitës: “Opozita, u zhgënjye nga humbja që pësoi në zgjedhjet për Kuvendin Kushtetues (dhjetor 1923). Qysh në fillim, ajo ushtroi një presion të madh për demokratizimin e sistemit të zgjedhjeve, kundër ndërhyrjes manipuluese të qeverisë në zhvillimin e tyre. Me përfundimin e zgjedhjeve, më 27 dhjetor 1923, opozita siguroi 1/3 e vendeve në Kuvend, rezultat që nuk e kënaqi aspak. Për këtë e akuzoi rëndë qeverinë e Ahmet Zogut se kishte manipuluar zgjedhjet.”<sup>34</sup> Këtu autorja ka dhënë një argument që shkon pranë së vërtetës. Opozita mbeti e zhgënjyer dhe për këtë shkak iu kthye metodave jo legale të luftës politike kundër qeverisë. Por pikëpamja se qeveria që në gjendje të manipulonte zgjedhjet është e paargumentuar dhe e dyshimtë për dy arsye. *Së pari*, opozita kontrolloi gjatë zgjedhjeve Ministrinë e Brendshme. *Së dyti*, rezultati i zgjedhjeve, ku asnjëra palë nuk fitoi shumicën qeverisëse, dhe rezultai i ngushtë midis opozitës dhe qeverisë provojnë të kundërtën. Fatin e qeverisjes në këto rrethana mund ta vendoste vetëm grupi i deputetëve të pavarur që drejtoheshin nga I. Vrioni. Zogu me anë të një politike më realiste dhe pragmatiste arriti, më në fund, ndonëse me shumë vështirësi, të bashkohej me të pavarurit ndërsa opozita dështoi në këtë drejtim.

Ky dështim e radikalizoi opozitën. Aq destruktiv ishte roli i një pjese të opozitës në këto çaste tepër kritike për vendin, sa që ajo organizoi atentatin kundër kryeministrit në shkallët e parlamentit, çka ishte një goditje tjetër e rëndë dhe tepër e rrezikshme, me pasoja shkatërrimtare, kundër stabilitetit të vendit dhe institucioneve politike të tij.

---

<sup>34</sup> Aurela Anastasi, *Historia e të Drejtës Kushtetuese në Shqipëri 1912-1939*, Tiranë: Pegi, 2007, f. 54.

### **Opozita në fillimin e vitit 1924**

Nga marsi i vitit 1924, qeveria kishte përballë dy kundërshtarët më të vendosur: forcat përparimtare të mbledhura rreth Nolit dhe “Komitetin e Kosovës”. Ndërsa në Tiranë po ashpërsoheshin diskutimet për formimin e një kabineti të ri, periferia veriore e vendit përballëj me një zi buke të ashpër, sa që u desh ndihma e Lidhjes së Kombeve për ta lehtësuar.<sup>35</sup> Siç ka shkruar me të drejtë edhe Eqrem Vlora, “Tirana në atë dimër të 1923/24-ës nuk të ofronte, siç vazhdojnë të besojnë edhe sot disa fantastë, pamjen e një qendre liberale, demokratike, por në rastin më të mirë, të një çerdhjeje mjerane intrigash ...”.<sup>36</sup>

Por, pavarësisht se kush ishte përgjegjës, vrasja e Rustemit e ndryshoi rrënjësisht gjendjen. Opozita, ishte e palëkundur në përpjekjet e saj për t’ia ngarkuar vrasjen Zogut edhe pse në këtë përfundim arritën për arsye të pastra politike. Më pas, në autobiografinë e tij, Noli do të nënvizonte se, vrasja e Rustemit ishte “shkaku për fillimin e revolucionit kundër Ahmed Zogut”. Ky vlerësim është pranuar nga shumë studiues. Edhe Grant –Smith shënonte se: “rasti i vrasjes së Avni Rustemit, ishte kapur nga anëtarët e opozitës për të ndërmarrë një revolucion, që me sa duket kishte kohë që komplotohet”. Meqenëse supozohej që Zogu ishte përgjegjës direkt apo indirekt, ky ishte sinjal për opozitën, se ai po bënte plane për të eliminuar fizikisht kundërshtarët e tij. Studiuesi R. Austin ka arritur në përfundimin se, “forcat rreth Nolit kërkonin me padurim një shkak për t’u vënë në lëvizje kundër qeverisë dhe të impononin zgjedhje të reja ose ndryshime revolucionare. Tërheqja nga Asambleja, vetëm e grupit të Nolit, nuk ishte e mjaftueshme për të imponuar ndryshime. Vrasja e Avni Rustemit, ishte justifikimi që prisnin forcat antiqeveritare dhe ata e shfrytëzuan deri në fund.”<sup>37</sup>

Por, ajo që nuk e peshuan fare, opozitarët e vitit 1924, ishte rreziku që sillte ky konflikt civil në Shqipëri, për vetë ekzistencën e shtetit shqiptar dhe për procesin e konsolidimit të tij. Përveç ambicies për pushtet dhe urrejtjes së shfrenuar kundër Zogut, që ishte karakteristike e përbashkët e të gjitha grupeve dhe përveç disa iluzioneve të turbullta të Nolit dhe grupit të tij të vogël, për reformën agrare, asgjë të justifikueshme, nuk kishte në aksionin politik kaq ekstrem të opozitës. Me këtë veprim, opozita, jo vetëm

<sup>35</sup> R. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit* ..., f. 69.

<sup>36</sup> Eqrem bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2003, f. 499.

<sup>37</sup> R. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit* ..., 72-74.

cenoi rëndë procesin e stabilizimit të shtetit shqiptar dhe vuri në pikëpyetje ekzistencën e tij, por ajo ishte haptazi, në kundërshtim me dëshirat e popullit shqiptar, i cili kërkonte qetësi dhe stabilizimin e jetës shtetërore.

Kjo papjekuri dhe infantilitet, do t'i kushtonte rëndë vendit dhe madje edhe vetë opozitës, e cila pas dhjetorit 1924, do të pushonte së funksionuari si një institucion legal, duke i shkaktuar një kthim prapa në sistemin politik, i cili do të kalonte qartësisht drejt autoritarizmit. Shqipëria, për dekada të tëra, do të humbiste mundësinë e ndërtimit dhe funksionimit të opozitës legale.

### *S u m m a r y*

#### THE POLITICAL ACTIVITY OF THE OPPOSITION AND OPPOSITARISM IN ALBANIA IN 1921-1924

The opposition and oppositarism were crucial institutional components of the political system in Albania during 1921-1924. The Albanian opposition left its trace in all the political, social and cultural developments of the country during this period. It was also the beginning and a historical apical limit in the process of constitution of a democratic state and society in Albania.

In this study paper, broadly based on Albanian, British and Italian Archival sources, as well as on a wide range of Albanian and foreign historiography bibliography several important scientific problems have been treated and new analyses have been carried out on them:

- The set up of the opposition, the way it was set up and its run and reorganization during 1920-1924.
- The social-political constitution of the opposition, its consisting groups, its inner organizational, political, ideological and social cohesion.
- The relations of the opposition to the national question.
- The relations of the opposition to the government and the way of governing.
- The political activity of the opposition within the frame of the constitutional institutions of the country
- The military unconstitutional activity of some oppositional groupings, its political and juridical reasons and consequences.

Thus several problems have been treated and new conclusions have been drawn having in the basis of these analyses the nature, the qualities and the outlines of the political activity of a normal opposition in a democratic system.